



KONKURSI PËR PËRZGJEDHJEN E BRAND-IT (Rrjeti i dyqaneve me prodhime TIPIKE shqiptare)

Konkursi për përzgjedhjen e brand-it të rrjetit më të ri të dyqaneve me prodhime tipike shqiptare, nxit idetë inovative mbi ideimin e një brand-i sa më dinjitoz, i cili përfshin logon, emrin, sloganin, dizajnin, pamjen vizuale në 3D si dhe arredimin e dyqaneve me prodhime shqiptare.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në kuadër të promovimit të produktit shqiptar, mbështetur në punën e deritanishme të bërë nga shumë bujq, fermerë, agropërpunues dhe artizanë shqiptarë, projektoi krijimin e një rrjeti dyqanesh me produkte cilësore vendase.

Rëndësia që i jepet ushqimit tradicional dhe produkteve ushqimore autoktone, është e njohur në tërheqjen e turistëve të huaj ose vendas. Produktet tipike të vendit tonë manifestojnë një pjesë bazë të kulturës shqiptare dhe bëjnë të mundur që vizitorët të marrin me vete një eksperiencë unike, prandaj ky rrjet dyqanesh, për të promovuar sa më mirë produktet shqiptare duhet të përmbushë këto kritere:

- Produktet e tregëtuara do të jenë 100 % TIPIKE shqiptare, me origjinë nga territori dhe trevat e Shqipërisë.
- Dyqani duhet të paraqesë produktet më të mira të prodhuesve shqiptarë, me standardet maksimale që nga cilësia deri tek paketimi dhe marketimi i produktit.
- Vendndodhja e dyqaneve duhet të jetë në një zonë qendrore dhe të aksesueshme nga turistët vendas dhe të huaj.
- Ambjentet e brendshme dhe të jashtme të dyqanit duhen dizenuar duke respektuar rreptësisht elementet tradicionale kombëtare në përputhje me ata modernë të kohës.
- Sugjerim mbi lëndët ndërtuese dhe arredimin: materiale te riciklueshme, dru, kashtë, hekur, gur, etj. (këto të lidhen jo vetëm me produktet e dyqanit por dhe të nxjerrin në pah kulturën shqiptare)

Konkursi për përzgjedhjen e brand-it fton të gjithë të interesuarit, të dorëzojnë propozimet e tyre nga **data 1 Shkurt deri në datën 21 Shkurt 2017**.

1. Qëllimi i konkursit për përzgjedhjen e brand-it është:

- Ideimi i një logoje që përfaqëson denjësisht markën/produktin Tipik shqiptar
- Krijimi i një brand-i inovativ, tërheqës dhe të qëndrueshëm.
- Logo/Slogan i përshtatshëm brenda dhe jashtë Shqipërisë
- Ideimi i një projekti Vizual ne 3D i arredimit të dyqanit TIP



2. Procedura e vlerësimit:

Ky konkurs do të zhvillohet në dy faza:

- Faza e parë do zhvillohet brenda një jave për të përzgjidhur 10-15 aplikantët e parë, të cilët do të përmbushin idenë më të përafërt.
- Faza e dytë do të zhvillohet pas përzgjedhjes, ku fituesit do të paraqesin punimet e tyre në eventin përmbyllës, ku do të shpallet fituesi.

Në përfundim të të gjitha fazave të konkursit, fituesi do të vlerësohet me cmimin prej 5000\$.

Të gjitha propozimet konkurruese do të vlerësohen nga një juri e përbërë nga:

- Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, z. Niko Peleshi
- Përfaqësues i RED (Regional Economic Development) z. Rezart Sako
- Kryeredaktore RTSH, znj. Yllka Gjipopulli
- Ekspertë të fushës

3. Kush mund të aplikojë dhe si?

Në konkursin për përzgjedhjen e brand-it të rrjetit të dyqaneve me prodhime tipike shqiptare mund të marrin pjesë:

- Të gjithë të interesuarit: studentët e universiteteve, individë, studio, kompani të fushës, etj.

Aplikantët e interesuar për pjesëmarrje në konkurs mund të plotësojnë formularin e aplikimit në faqen zyrtare www.bujqesia.gov.al.

Të gjitha aplikimet, me projekt idetë përkatëse mund të ngarkohen në format PDF, brenda formatit të mësipërm.

Aplikantët të përzgjedhur nga juria do të njoftohen brenda datës 23 Shkurt 2018 dhe do të ftohen për të prezantuar idetë e propozuara, në eventin përmbyllës, në **datën 26 Shkurt 2018**.